

meddha në Dekretet
për të cilin ministri në
të një të vullshëm që
Allëndin në e, a se
për në hox me të sh
ti, that i kam marrë

dua janë me
- i tha ngjall
t'a vris jin
kryetë : Aqth

BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS

60 vjet

ti, Act i kam marrë
sigur.

Shekulli i kaluar
kam "Committee", them-
ton informacione, që
nëqytet : "me të sh
mire Shqipërisë, për dësh
dhia kollë të përhapin
si kush në ka marrë
Bullgaret janë me të
Shqipëtarët amie. E
kompletisht për Bullgaret.

me për sot. Pësi
gëlltë me e i kam
are kush i burdohet
bin i sh.

Legjiti "shkollë" i shkollës
me të cilin

me këna në "Cal-
me të të dergoj
Inglizet dëlit
me të i Bajac të
me i tyri i ma-
vullshëm, dhe
me këna që
nëqytet me të
loj, kam njëft

me të dua në
me këna që të
llëviz idhe
me të

Prishtinë
2004

ISBN 9951-73-070-0

BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS
60 VJET

Botues:

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Drejtor: Dr. Sali Bashota

Përgatitën:

Fazli Gajraku

Bedri Gashi

Gjon Berisha

Dizajni & Realizimi kompjuterik:

Ramush Zeka

Hekuran Rexhepi

© 2004, BKUK

Adreasa: Sheshi "Hasan Prishtina", p.n. Prishtinë
Tel: ++381 38 225-605, 249-650 Fax: ++381 38 248-940
e-mail: biblioteka@biblioteka-ks.org

www.biblioteka-ks.org

BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS

60 VJET


(udhërrëfyes)

**BIBLIOTEKA
KOMBËTARE DHE
UNIVERSITARE
E KOSOVËS**



**THE NATIONAL
AND UNIVERSITY
LIBRARY
OF KOSOVA**

**Prishtinë
2004**





HYRJE

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës është institucion bibliotekar qendror dhe qendër e informacionit bibliotekar në nivel kombëtar, që mbledh, përpunon dhe ruan materialet bibliotekare me vlerë dokumentare për kulturën, artin dhe shkencën. Ky institucion kryesor i ruajtjes së kujtesës - trashëgimisë, është qendër:

- e depozitimit të kopjes së detyrueshme dhe e mirëmbajtjes së katalogut përmledhës kombëtar të të dhënave;
- e studimeve në fushën e bibliotekarisë, bibliografisë dhe të informacionit;
- e koordinimit të rrjetit kombëtar bibliotekar;
- e restaurimit dhe e konservimit të materialeve.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës bën përgatitjen e Katalogimit në Botim (CIP); dhënien e Numrit Standard Ndërkombëtar (ISBN - Numri Standard Ndërkombëtar për Botime Monografike dhe ISMN - Numri Standard Ndërkombëtar për Muzikalie); harton dhe boton bibliografi dhe materiale të tjera nga fusha e bibliotekarisë; zhvillon programe për trajnim dhe aftësim profesional të punëtorëve bibliotekarë.







HISTORIA

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës është themeluar në nëntor të vitit 1944, në Prizren. Ky institucion qendror i bibliotekarisë, që ka kaluar nëpër faza sfiduese të zhvillimit – të lidhura me fatin dhe historinë e Kosovës, është i njohur, si: Biblioteka Krahinore (1944-1952), Qendra Bibliotekare e KAKM-së (1956-1961), Biblioteka Popullore Krahinore (1961-1970), Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës (1970-1990), Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës e Metohisë (1990-1999), ndërsa nga viti 1999 - Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës. Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës është zhvendosur nga Prizreni në Prishtinë në vitin 1946 dhe prej atëherë ndërroi vendin pesë herë (1944, 1946, 1962, 1964, 1982).

* * *

Ndërtesa e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, me dritare zenitale në formë të kupolave (gjithsej 99 kupola), është inauguruar në vitin 1982. Hapësira e brendshme përfshin 16.500 m². Biblioteka ka sallat e leximit për përdorues me 600 vende - dy salla të mëdha, sallën e periodikut, si dhe sallat e leximit për punëtorë shkencorë. Në bibliotekë, gjithashtu, është edhe Amfiteatri i Madh - me 150 ulëse dhe Amfiteatri i Vogël me 75 ulëse, ku zhvillohen aktivitete dhe veprimtari me karakter informativ, kulturor e shkencor. Gjatë vitit anëtarësohen mbi 4000 përdorues, ndërsa rreth 2000 përdoruesve u ofrohen shërbime çdo ditë.





Biblioteka ka edhe Shërbimin e Restaurimit dhe të Konservimit, Qendrën e Internetit për Përdorues, Qendrën e Trajnimeve, Arkivin Medial, Dhomën e Shkrimtarëve, si dhe Qendrën Informativë për Qeverisje Parlamentare (QIQP).

* * *

Gjatë fundviteve '80-të e deri në vitin 1999 (periudha e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë), është dëmtuar fondi bibliotekar dhe është shkatërruar infrastruktura e Bibliotekës.

Në vitin 1990 pushteti okupues serb aplikoi masat e dhunshme dhe, ndërkohë, përjashtoi bibliotekarët shqiptarë nga puna. Përdoruesve shqiptarë iu mohua e drejta për shërbime, kurse në hapësirat e brendshme të Bibliotekës u strehuan refugjatë serbë nga Kroacia dhe Bosnja. Në periudhën mars - maj 1999, gjatë ndërhyrjes së NATO-s, Biblioteka ka shërbyer si bazë e ushtrisë serbe.

Në gjysmën e dytë të vitit 1999, pas çlirimit të Kosovës, përkatësisht filimit të proceseve demokratike, punëtorët shqiptarë të Bibliotekës u

kthyen në punë.

Gjatë viteve 1999 – 2002, problemet në menaxhim ndikuan në procesin e zhvillimit të veprimtarisë bibliotekare. Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë emëroi Bordin Ekzekutiv nga ekspertë ndërkombëtarë dhe vendës. Nga tetori i vitit 2002 deri në mars të vitit 2003, si rezultat i bashkëpunimit mes

Ministritë dhe Zyrës Amerikane në Prishtinë, erdhi eksperti i bibliotekarisë - dr. Kenneth J. Oberembt, i cili, në cilësinë e drejtorit të përkohshëm udhëhoqi këtë institucion dhe hartoi Planin Strategjik për Bibliotekën Kombëtare dhe për Bibliotekën Universitare të Kosovës.

Pas përfundimit të misionit të drejtorit të përkohshëm, në janar të vitit 2003, për të zhvilluar veprimtarinë bibliotekare, drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës u zgjodh - dr. Sali Bashota - kohë kur edhe filloi të zbatohet plani sipas strukturës së re organizative.





KOLEKSIONET



Koleksionet e përgjithshme

Koleksionet e Përgjithshme të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës përfshijnë depozitimin e të gjitha materialeve bibliotekare që botohen në Kosovë, të siguruar nga ekzemplari i detyrueshëm - botime të botuesve dhe shtypshkronjave në Kosovë. Pasurimi i fondeve plotësohet, me botime vendëse dhe të huaja, edhe me blerje, dhuratë dhe shkëmbim.

Në fondin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare e Kosovës janë afër 2 milionë njësi bibliotekare, koleksione të shtypit periodik dhe materiale të tjera sipas llojit të materialit dhe përmbajtjes.

Koleksionet e Veçanta

Në fondin e Koleksioneve të Veçanta që përfshin gjithë materialin e rrallë dhe të vjetër, janë 40775 njësi bibliotekare, nga të cilat - 1819 tituj librash, 294 tituj periodiku, 779 tituj dorëshkrimesh, ndërsa sasia tjetër përbëhet nga materiale të tjetra bibliotekar, si: harta dhe atlase, mikrofilma, pllaka gramafoni, materiale audiovizuale etj.

LASGUSH PORADICI

YLLI I ZEMRËS



TRITUAR NËNË KUDESHEN E M. KUTELI

1911



Librat e rrallë

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ruan 5302 libra të rrallë e të vjetër. Në këtë fond të librave të rrallë e të vjetër ruhen vepra, si: Ioan Petri Contareni, *Veneti historiae de bello nuper venetis a Selimo II, Tvrçarvm Imperatore*, Bazel 1573, Tefë (Stefë) Curani, *Të nollunat e Shqypnis, Skenderie* 1898, Jani Vreto, *Mirevetija*, Bukuresht 1886, *Hristomaci në katër pjesë*, Sofje 1902, Naim Be Frashëri, *Dëshirë e vërtetë e shqiptarëve*, Sofje 1912 etj.

Periodiku i rrallë

Në fondin e periodikut të rrallë janë 300 tituj, përkatësisht 4160 njësi periodiku. Ky



koleksion i gazetave dhe i revistave të zgjedhura (i pakompletuar në numra) - me traditë të gjatë dhe të shkurtër botimi, të përditshme, të përjavshme, të përmuajshme dhe të përkohshme, përfshin periodikun prej vitit 1883.


Në fondin e periodikut të rrallë ruhen titujt, si: "*Fiamuri Arbërit*" i De Radës (1883), "*Shqipëria*" e Bukureshtit (1897), "*Albania*", Bruksel (1897), "*Kalendari Kombiar*", Sofje (1903), "*Laimtari i Scypenies*", Roma (1905), "*La Nazione Albanese*", Roma (1907), "*Dielli*" i Bostonit (1909), "*Zgjimi*", Korçë (1914), "*Iliria*", Boston (1916), "*Hylli i Dritës*" - Shkodër (1921), "*Leka*", Shkodër (1936), "*Përpejka Shqiptare*", Tiranë (1938) etj.



Dorëshkrimet

Në fondin e koleksioneve të dorëshkrimeve ruhen 779 dorëshkrime - shqipe me grafi latine, greke dhe arabe. Pjesa dërrmuese janë dorëshkrime orientale në gjuhën arabe, osmane dhe persiane, por ka edhe dorëshkrime shqipe me alfabet oriental.

Nga dorëshkrimet në gjuhën shqipe me alfabet latin, janë: *Letrat e Filip Shirokës*, dërguar nga Bejruti redaksisë “*Drita*” dhe “*Shqiptari*” - Bukuresht (1891), *Gjashtë letrat e Faik Konicës*, nga Parisi, Brukseli dhe Londra, dërguar Nikolla Naços në Bukuresht (1896-1905), *Letrat e Ndre Mjedjes*, (1893), dorëshkrimet e Josip Relës etj.



Dorëshkrimi më i vjetër oriental është ai i dhuruar nga biblioteka e Hasan Efendi Nahit, kopjuar në vitin 1347. Ndër dorëshkrime orientale, janë edhe: “*Pendnameja*” e Feriduddin Muhammed b. Ibrahim Attari-it, kopjuar në vitin 1635, “*Divani*” i Sylejman Axhize Babës, Shkodër? - Prizren (1717), “*Vehbija*” e Tahir Gjakovës, autograf, shkruar në vitin 1835, “*Trajtesë nga fusha e logjikës*”, përpiluar nga Mahmud B. Abdyl - Halim (Gjakova) në vitin 1835.



STRUKTURA ORGANIZATIVE

1. Departamenti i Përpunimit të Materialit Bibliotekar

Shërbimi i Pasurimit të Fondeve

Pasurimi (ekzemplari i detyrueshëm, blerja, dhurata, shkëmbimi ndërbibliotekar, përpunimi fizik)

Shërbimi i Përpunimit të Librit

Katalogimi, Klasifikimi, CIP, ISBN, ISMN

Shërbimi i Përpunimit të Periodikut

Katalogimi, Klasifikimi, ISSN, Arkivi Medial

2. Departamenti i Koleksioneve të Veçanta

Koleksioni i Dorëshkrimeve, i Librit të Rrallë dhe të vjetër, i Hartave, i Foto-dokumenteve, i Muzikalieve dhe i Fonodokumenteve, i Kopjes Arkivore, i Legateve, i Materialit të Imtë.

Shërbimi i Restaurimit dhe i Konservimit

Restaurimi dhe Konservimi, Mikrofilmimi dhe Skanimi, Fotokopja dhe Libërlidhja.

**3. Departamenti i Bibliografisë**

Bibliografia e Librit në Kosovë

Bibliografia e Botimeve Periodike në Kosovë

Qendra për Informata Shkencore dhe Veprimtari Referale

Koleksioni i Punimeve të Doktoratave dhe Magistraturave

4. Departamenti i Huluntimit dhe i Zhvillimit të Veprimtarisë Bibliotekare

Shërbimi Amë

Qendra e Trajnimit të Bibliotekarëve

Njësia e Koleksionit Profesional (Fondi B)

5. Departamenti i Informacioneve dhe i Shërbimeve Bibliotekare**Shërbimi i Informacionit**

Skedarët

Shërbimi i Përdoruesve

Regjistrimi, Porosia e Librit, Salla e Përdoruesve, Qendra e

Internetit

Shërbimi i Koleksioneve të Deponuara

Depoja e Librit, e Periodikut, e Fondeve të Veçanta

6. Departamenti i Burimeve dhe i Shërbimeve Kompjuterike

Rrjeti Lokal i Bibliotekës (LAN-Local Area Network)

Menaxhimi Programit Bibliotekar - ExLibris (ALEPH 500)

WEB Dizajni dhe Digjitalizimi

7. Departamenti i Administratës

Shërbimi i Përgjithshëm

Shërbimi i Kontabilitetit dhe i Financave

Shërbimi Teknik

Shërbimi i Sigurimit

i. Konsorciumi i Bibliotekave Elektronike (eFL)

A. Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë

B. Zyra e Botimeve

LAINE
KASHERIN
1025



1. DEPARTAMENTI I PËRPUNIMIT TË KOLEKSIONEVE BIBLIOTEKARE

Departamenti i Përpunimit të Koleksioneve Bibliotekare organizon dhe udhëheq mbledhjen dhe koleksionimin e materialit bibliotekar për të krijuar pasqyrë përmbledhëse të trashëgimisë së kulturës të Kosovës.

Shërbimi i Pasurimit të Fondeve

Udhëheq infrastrukturën menaxhuese të grumbullimit të materialit bibliotekar, si dhe pranon, fakturon dhe evidenton materialin e siguruar nga: ekzemplari i detyrueshëm, blerja, dhurata dhe shkëmbimi.

Ky Shërbim identifikon dhe komunikon me të gjithë botuesit dhe shtypshkronjat vendëse, si dhe bashkëpunon me botuesit e huaj, me qëllim të pasurimit të fondeve; krijon fondin rezervë (fondin për shkëmbim) dhe plotëson në vijimësi mungesat e fondit të rregullt.



Shërbimi i Përpunimit të Librit

Udhëheq dhe përpunon të gjitha publikimet monografike sipas standardeve ndërkombëtare; plotëson skedarët publikë dhe internë; katalogon publikimet në gjuhën shqipe dhe të huaj; katalogon librat; redakton njësitë skedarike; alfabetizon njësitë kataloguese; bën Katalogimin në Publikim (CIP) të të gjitha dorëshkrimeve, para se ato të botohen.

Në kuadër të këtij Shërbimi bëhet edhe klasifikimi i të gjitha botimeve monografike në gjuhën shqipe dhe të huaj, sipas rregullave dhe udhëzime për klasifikim; klasifikohen dorëshkrimet për Katalogim në Publikim (CIP); plotësohet dhe mirëmbahet skedari sistematik; redaktohen indeksat e njësive skedarike; përcillen të gjitha risitë dhe zhvillimet në fushën e klasifikimit.



Shërbimi i Përpunimit të Periodikut

Udhëheq infrastrukturën menaxhuese të grumbullimit të periodikut, si dhe pranon dhe inventarizon në Inventarin e Pranimit dhe në Inventarin e Signaturës gazetat dhe revistat; klasifikon, katalogon të gjitha publikimet periodike sipas standardeve ndërkombëtare – ISBD(S); plotëson dhe mirëmban skedarët publikë dhe internë; plotëson kartototekën vijuese; përcjell të gjitha risitë dhe zhvillimet në fushën e botimeve periodike; redakton të gjitha njësitë periodike; alfabetizon njësitë e katalogut dhe të kartotekës; ofron informata për përdorues.

Arkivi Medial

Në maj të viti 2004, në përbërje të Shërbimit të Përpunimit të Periodikut është formuar Arkivi Medial. Formimi i këtij Arkivi është realizuar me iniciativën e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, profesor Rexhep Shahinit, Asociacionit të Gazetarëve Profesionistë të Kosovës dhe Press Now.

Fondi i Arkivit përmban koleksione të gazetave dhe të revistave të dhjetëviteshit të fundit. Ky është promovimi për herë të parë

i Koleksioneve të Hapura në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

2. DEPARTAMENTI I KOLEKSIONEVE TË VEÇANTA

Organizon dhe udhëheq pasurimin e Fondeve të Veçanta dhe i ruan ato. Departamenti hulumton informacione për vendndodhjen e materialeve të vjetra e të rralla - me vlerë të veçantë për trashëgiminë; harton plane dhe projekte mbi mundësitë e mbledhjes së këtyre materialeve; negocion me pronarët vendës dhe të huaj për materialet me vlerë që ata i posedojnë, si dhe vlerëson dhe përzgjedh materialet që meritojnë të ruhen përgjithmonë. Departamenti inventarizon, klasifikon, katalogon dhe redakton njësitë skedarike të koleksioneve të rralla dhe të vjetra.

Tash për tash, ky Departament arrin të përpunojë formatet e koleksioneve: libra të rrallë, dorëshkrime, harta, muzikalie dhe fonodokumente.





Shërbimi i Restaurimit dhe i Konservimit të Materialit Bibliotekar

Shërbimi është përgjegjës për restaurim, konservim, mikrofilmim, skanim dhe libërlidhje të koleksioneve bibliotekare dhe për mbikëqyrjen, në përputhje me kushtet, të koleksioneve bibliotekare të deponuara.

Gjatë procesit të restaurimit të materialeve bibliotekare, hulumtohen mënyrat se si do të trajtohet materiali që është në proces të restaurimit.

Ky Shërbim, gjithashtu, arkivon dhe ruan të gjitha informatat për kohën dhe mënyrën e trajtimit të materialit të restauruar, si dhe krijon kritere dhe standarde për kushtet në të cilat ruhen materialet ekzistuese të sistemuara në depo.

3. DEPARTAMENTI I BIBLIOGRAFISË

Organizon dhe udhëheq hulumtimet në fushën e bibliografisë; përpilon bibliografi retrospektive dhe vijuese të publikimeve monografike dhe serike, artikuj të zgjedhur - duke u mbështetur në parimin “de visu” (drejtpërdrejt nga burimi) sipas rregullave ndërkombëtare të hartimit të bibliografive ISBD(M) dhe KUD.

Departamenti i kushton rëndësi të veçantë hulumtimit dhe hartimit të bibliografisë kombëtare dhe synon të marrë kontrollin shkencor të të gjitha botimeve, të cilat i mbledh Biblioteka.

Departamenti ka të botuara vëllimet bibliografike të revistës: “Jeta e Re” (tri vëllime) (1949-1989), “Stremjenja” (1960-1990) dhe “Koha” (1978 - 1989).



Qendra për Informata Shkencore dhe Veprimtari Referale

Qendra hulumton informacionet e mundshme - kudo që ekzistojnë ato, mbledh dhe sistematizon materialet referuese - me interes për institucionet shkencore, hulumtuese, organizatat e ndryshme dhe për shkencëtarë e për profesionistë të tjerë.

Në këtë qendër përfshihen koleksionet e punimeve të doktoratave dhe të magistraturave. Qendra ka të botuara: “Bibliografi e disertacioneve të doktoratave të Kosovës 1947-1982” dhe “Katalogu i botimeve të huaja periodike në bibliotekat e Kosovës në vitin 1978”.



4. DEPARTAMENTI I HULUMTIMIT DHE I ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË BIBLIOTEKARE

Departamenti i Hulumtimit dhe i Zhvillimit të Veprimtarisë Bibliotekare është gjeneratori kryesor i zhvillimit të hulumtimit dhe të aftësisë profesionale, të mësimdhënies dhe të shkollimit të vazhdueshëm në lëminë e bibliotekarisë si dhe i mbikëqyrjes së të gjitha bibliotekave dhe të personelit të tyre në Kosovë.



Shërbimi Anë

Mbikëqyr çështjet profesionale të bibliotekave: ndërkomunale, komunale, universitare, speciale, shkencore dhe shkollore; unifikon rrjetin bibliotekar të Kosovës; hulumton, studion dhe paraqet nevojat e bibliotekave dhe kujdeset për zbatimin e metodave dhe standardeve ndërkombëtare në fushën e bibliotekarisë.

Qendra e Trajnimit të Bibliotekarëve

Harton strategji të formave të trajnimit për stafin e bibliotekave në Kosovë si dhe organizon tribuna, seminare, ligjërata profesionale dhe ekspozita kulturore e shkencore.

Njësia e Koleksionit Profesional (Fondi B)

Në këtë njësi inventarizohet, klasifikohet dhe katalogohet literatura profesionale dhe referuese (fjalorë, enciklopedi, udhëzues, informatorë, bibliografi, katalogë) nga fusha e bibliotekarisë.



5. DEPARTAMENTI I INFORMACIONEVE DHE I SHËRBIMEVE BIBLIOTEKARE

Departamenti i Informacioneve dhe i Shërbimeve Bibliotekare organizon dhe udhëheq tërë rrjetin e informatave. Është përgjegjës përball përdoruesve për të dhënë informacione dhe udhëzime për kërkim dhe përdorim; bën huazimin ndërbibliotekar (nëse Biblioteka në fondet e veta nuk i posedon publikimet e kërkuesit) të informatave.



Shërbimi i Informacionit

Shërbimi i Informacionit ofron udhëzime, informata, (huazime të informatave) për përdoruesit; informacion për skedarët alfabetikë, sistematikë, topografikë dhe të periodikut.



Shërbimi i Përdoruesve

Ky Shërbim kryen porosinë dhe rezervimin e materialeve të kërkuesit nga përdoruesit; huazimin ndërbibliotekar, mbikëqyrjen e sallave të përdoruesve, si dhe anëtarësimin e tyre në Bibliotekë.


Shërbimi i Koleksioneve të Deponara

Shërbimi vendos dhe rendit materialin e përpunuar bibliotekar - në bazë të formateve dhe signaturës, në depo. Jep në përdorim materialet e porositura, bazë të porosive të marra nga Shërbimi i Përdoruesve, por

dhe rikthen në raftet materialet që janë përdorur nga përdoruesit.

Qendra e Internetit

Qendra ofron shërbime për qasje në rrjetin global (Internet) dhe në burimet elektronike të siguruar nga Konsorciumi i Bibliotekave Elektronike të Kosovës, si dhe kryen shërbime për anëtarësim në këtë qendër.



6. DEPARTAMENTI I BURIMEVE DHE I SHËRBIMEVE KOMPJUTERIKE

De partamenti i Burimeve dhe i Shërbimeve Kompjuterike është në proces të implementimit, përkatësisht të udhëheqjes dhe të organizimit, të sistemit bashkëkohor të integruar bibliotekar; të forcimit të rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm; të kalimit nga komunikimi në letër në atë elektronik; të mbledhjes së burimeve elektronike, që i plotësojnë koleksionet e shtypura, si dhe të qasjes në burime dhe shërbime të tjera elektronike.

Rrjeti Lokal Bibliotekar (LAN)

Kjo njësi e Rrjetit të komunikimit lokal (Intranet) mundëson këmbimin e informatave dhe komunikimin ndërbibliotekar, si dhe mirëmban serverët e sistemit të automatizuar për programet kompjuterike dhe për rrjetin.

Programi Bibliotekar - ExLibris (ALEPH500)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ka nënshkruar kontratë me Kompaninë Ex Libris për të implementuar Sistemin ALEPH 500.

Me zbatimin e sistemit të integruar, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës po kalon nga faza e komunikimit tradicional në atë elektronik. Implementimi i këtij programi parasheh aftësimin e stafit dhe të përdoruesve për sistemin e ri bibliotekar.

WEB Dizajni dhe Digjitalizimi

Kjo njësi, me implementimin e Programit ALEPH 500, do të bëjë digjitalizimin e fondit bibliotekar dhe të fondeve të rralla dhe të vjetra, si dhe do të mirëmbajë Web Faqen e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës: www.biblioteka-ks.org.



7. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS



Departamenti i Administratës udhëheq dhe organizon çështjet administrative, juridike, financiare, teknike dhe të sigurisë në Bibliotekë.

Shërbimi i Përgjithshëm

Përgatit dhe përpunon paraprojektet e akteve të përgjithshme normative dhe të lëndëve, përgatit akte zyrtare, sipas dispozitave ligjore, përcjell zbatimin e tyre, si dhe evidenton dhe arkivon ato.

Shërbimi i Kontabilitetit dhe i Financave

Harton planin financiar dhe analizon realizimin e llogarive periodike dhe përfundimtare; përcjell dhe kontrollon përdorimin e mjeteve të investuara dhe atyre të dedikuara; organizon punët në kontabilitet; organizon dhe kontrollon buxhetin, punon në revalorizimin e mjeteve themelore, shqyrton të gjitha pagesat e kryera nëpërmes arkës dhe bankës, si dhe përcjell ligjshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit.

Shërbimi Teknik

Analizon dhe mirëmban infrastrukturën e Bibliotekës, kontrollon dhe mirëmban pajisjet teknike; përpilon dokumentacion teknik për pajisjet dhe riparimet e bëra.

Shërbimi i Sigurimit dhe i Higjienës

Organizon kontrollin e sigurisë së personelit dhe të objektit dhe koordinon punët me institucionet e përgjithshme të sigurisë, si dhe organizon, kontrollon dhe mirëmban higjienën.

ΔΙΑΤΑ Ε ΡΕ

Ε ΖΟΤΙΤ ΕΔΕ ΣΕΛΒΟΥΕΣΙΤ Τ'ΥΝΕ

ΙΕΣΟΥ-ΚΡΙΣΤΙΤ,

ΚΕΘΥΕΜ ΠΡΕΙ ΓΡΕΚΙΣΤΕΣΕ ΒΙΕΤΕΡ

ΣΚΙΡ

ΝΔΕ ΟΥΗΕ ΓΕΓΕΝΙΣΤΕ

πρσι

ΚΟΝΣΤΑΝΤΙΝΙΤ ΚΡΙΣΤΟΦΟΡΙΔΙΤ, ΕΛΒΑΝΑΣΙΤ.

ΚΟΝΣΤΑΝΤΙΝΟΠΟΛ.

*Σίταγ νδγ Στεσβόλ, νδλ Φιλδάνδτιλρ-Υελνις,
νδγ Μαγασινγ τγ Βιβλιγ.*

Νδγ Στυπς-Εκρωγ τγ Α. Η. Βογρλιανιτ.

1872.



KONSORCIUMI I BIBLIOTEKAVE ELEKTRONIKE TË KOSOVËS

(eIFL - Burime Elektronike për Biblioteka)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ofron qasje në rreth 5000 tituj të revistave elektronike nga fusha e shkencës dhe teknologjisë. Ky shërbim mundësohet me ndërmjetësimin e Konsorciumit - një grup bibliotekash të bashkuara, që synon të rritë fuqinë në sigurimin e shërbimeve elektronike bibliotekare. Konsorciumi ofron qasje të barabartë dhe me një çmim të ulët blerës; bën aftësimin e bibliotekarëve dhe përdoruesve; jep këshilla dhe udhëzime për anëtarët e konsorciumit etj.

Bazat e të dhënave në të cilat Konsorciumi ka qasje janë, EBSCO, ProQuest dhe Cambridge University Press, ndërsa për bibliotekat e Kosovës (bibliotekat, të cilat nuk kanë qasje në internet), përdorimi mundësohet përmes CD-ROM-ve të siguruar me ndërmjetësimin e Konsorciumit të Bibliotekave Elektronike të Kosovës.

Të gjitha këto shërbime, me përkrahjen e Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), ofrohen falas deri në gjysmë të vitit 2005. Pas kësaj periudhe, përdorimi i këtyre burimeve do të bëhet me participim .

FIALUUR
I VOGHEL
SCC8P E LTINISCT
MLE3UN
PREI
P. JAK JUNKUT T'SCOGNIS JEEU



N'SCKODER T'SCC8PNIS 1895



ZYRA E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Bashkëpunimi ndërkombëtar


Bashkëpunimi i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës me institucionet bibliotekare të botës, realizohet në fushën e bibliotekarisë, por edhe në fusha të tjera me interes kulturor e shkencor. Zhvillimi i bashkëpunimit dhe i marrëdhënieve të Bibliotekës me jashtë, nis në vitet '70-të, me shkëmbimin e literaturës nga fusha e Albanikës dhe e Ballkanikës me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, Bibliotekën e Kongresit Amerikan në Uashington dhe më pas është zgjerua edhe me: Gjermaninë, Austrinë, Francën, Rumaninë, Hungarinë, Bullgarinë, Greqinë, Turqinë, Egjiptin, Sirinë etj.

Në vitet '80 - '90, marrëdhëniet e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare me institucionet bibliotekare ndërkombëtare u ndërpre në fushën e shkëmbimit e të dhurimit të fondeve, veçanërisht nga fusha e Albanikës.

Pas luftës, në fazën e monitorimit ndërkombëtar të Kosovës, fillon të intensifikohet bashkëpunimi me jashtë - në këtë kontekst ndihmoi ndërmjetësimi i përfaqësive diplomatike në Prishtinë, si: SHBA-ve, Gjermanisë, Francës, Spanjës, Zvicrës etj. Bibliotekat e këtyre vendeve, përveç ndihmës profesionale, Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës i dhuruan edhe materiale të vlefshme bibliotekare dhe ndihmuan në ndërtimin e përvojave profesionale në fushë të bibliotekarisë. Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës u rianëtarësua në IFLA (Federata Ndërkombëtare e Shoqatave dhe e Institucioneve Bibliotekare), në Agjencinë Ndërkombëtare të ISBN-së me qendër në Berlin, në eIFL-net (Electronic Information for Librarians).

Në shtator të vitit 2003, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës themeloi Zyrën për Marrëdhënie me Jashtë.

Me ndihmën e rrjetit të eIFL-net-it, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ka themeluar Konsorciumin e Bibliotekave Elektronike të Kosovës, i cili do të gjejë përdorim në rrjetin vendës. Në Bibliotekë, gjithashtu, është hapur Qendra Informative për Qeverisje Parlamentare (QIQP), e cila ofron qasje të lirë në të gjitha dokumentet qeveritare dhe parlamentare të Kosovës.





L'Albania deve essere una ed indipendente ed estesa nelle sue naturali provincie: l'Hylliria, la Macedonia, l'Epiro e la Tessalia. L'Albania degli Albanesi.



ZYRA E BOTIMEVE

Zyra e Botimeve harton plane dhe projekte për botime në fushën e literaturës bibliotekare dhe të kulturës në përgjithësi; përzgjedh dhe vlerëson materialet; siguron të drejtën e botimit; redakton dhe përgatit për shtyp.

Gjatë periudhës 2003 – 2004, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare ka nxjerrë mëse 15 botime (libër, revistë, bibliografi dhe udhëzues): Revista “*Bibliolettra*”, Nr. 1, 2, 3, Kenneth J. Oberembt, *Plani stategjik për Bibliotekën Kombëtare dhe për Bibliotekën Universitare I-II, Java e Bibliotekës në Kosovë, IFLA – Parimet mbi përkujdesjen dhe përdorimin e materialit bibliotekar, ISBN – Numri Standard Ndërkombëtar i Librit, EBSCO – Udhëzues për përdorimin e të dhënave të EBSCO-s, Bibliotekat dhe liria intelektuale, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës – udhërrëfyes, Konsorciumi i Bibliotekave Elektronike të Kosovës – informacione elektronike për biblioteka, Konsorciumi i Bibliotekave Elektronike të Kosovës – udhëzues, Tahir Foniqi, Bibliografia e revistës Koha 1978 – 1989, Vehbi Miftari, Bibliotekat në Kosovë dhe qasja në informata, Gjon Berisha, Bibliografia e revistës Kosova 1972 – 2003, Bedri Gashi, Sfîdat e zhvillimit të bibliotekave publike në Kosovë, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosoëvs – 60 vjet.*



BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS

60 VJET

BOTUES



BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS

**Shtypi Shtypshkronja
“Prograf” Prishtinë
2004**